

Njoftim

Sot, më datë **15.06.2023, ora 15:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Marsela Dervishi (Anëtare);**
- 4. Alma Kolgjoka (Anëtare);**
- 5. Emona Muçi (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.30 Regj.Themeltar, Datë 09.06.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri.

I paditur: Komisionit Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga Ina Osmanaj dhe Blendi Kodra.

Person i interesuar: Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Maringlen Legisi.

Objekti: Ndryshimin e Vendimit nr.175, datë 06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke vendosur:

1. Rinumërimin dhe Rivlerësimin e drejtë të votave në të gjitha qendrat e votimit të njësisë zgjedhore Bashkia Belsh si dhe miratimin e tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Bashkia Belsh, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i drejtë i votave;
2. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë, të zonës zgjedhore Bashkia Belsh;
3. Ndryshimin e Vendimit të KSHZ nr.533, datë 18.05.2023 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Belsh, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 14 maj 2023”, duke pasqyruar ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Belsh, duke mos përfshirë rezultatin e qendrës së votimit nr.2565/01 IEVP Burgu Kosovë; si dhe
4. Shpalljen si kandidat fitues për zgjedhjet për kryetar Bashkia Belsh të z. Bedri Qypi mbështetur nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

Baza ligjore: Neni 3/1, Neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ; Nenet 4, pika 1, Nenet 9, Neni 45, Neni 46 e vijues të Kushtetutës së Shqipërisë, Nenet 63, 64, 65, 98, Nenet

124, 126, 129 dhe 130 të ligjit, si dhe nenet 136, 139, 145 e vijues i Kodit Zgjedhor.

me Vendimin Nr. 29, datë 15.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimitisht,

VENDOSI

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës paditëse.
3. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
U shpall në Tiranë më datë 15.06.2023.

Tiranë, më 15.06.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë